

OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL ZAGJ-KGR		
Date / received / sent		
Classification code:	Year:	Reg. nr.

## KUVENDI I KOSOVËS

PASQYRA E ARKËTIMEVE DHE PAGESAVE PËR VITIN E  
31 DHJETOR 2005  
DHE  
RAPORTI I PAVARUR I AUDITORËVE

**PËRMBAJTJA**

**FAQE**

**Raporti i pavarur i auditorëve**

**Pasqyra e dëftesave dhe pagesave për vitin e përfunduar 2005**

**1**

**Shënime për pasqyrën e dëftesave dhe pagesave**

**2-6**

**Shtojcë 1 Buxheti sipas informatave aktuale**

**7**

## RAPORTI I PAVARUR I AUDITORËVE

### Për Presidencën e Kuvendit të Kosovës

Ne ishim të angazhuar për të audituar pasqyrat përcjellëse mbi Arkëtimet dhe Pagesat në Kuvendin e Kosovës ("Kuvendi"), të cilat përfshijnë pasqyrat e Arkëtimeve dhe Pagesave për vitin e përfunduar 31 Dhjetor 2005, përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël dhe vërejtjet tjera sqaruese ("pasqyrat financiare"). Këto Pasqyra Financiare janë përgjegjësi e Menaxhmentit të Kuvendit.

Pasqyra janë përgatitur sipas udhëzimeve të vëna në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, 'Raportimit Financiar sipas Bazës së të hollave të Kontabilitetit'.

Testimi i auditimit, i kryer në baza mostrimi, në shpenzimet e bëra në vitin 2005 tregojnë se disa raste rregulloret e prokurimit (Ligji mbi Prokurimin Publik 2003/17) nuk janë aplikuar plotësisht. Mospërputhja me rregulloret ngrit rrezikun e parregullsive të ndodhura dhe mbasin të pazbuluara.

Për më tutje, për disa artikuj të shpenzimeve nuk kishte evidenca të mjaftueshme për të përcaktuar nëse shpenzimi është aprovuar në mënyrë adekuate dhe shpenzim të mirëfilltë. Nëse politikat e prokurimit janë përputhje me shumat e shpenzimeve mund të janë të ndryshme.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të diskutuara në paragrafin paraprirës ne nuk shprehim opinion në pasqyra financiare.




Auditori Gjeneral  
Prishtina  
1 Gusht, 2006

**PASQYRA E ARKËTIMEVE DHE PAGESAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR 2005**

	Shënim	2005 Fondi I përgjithshëm Aktual (Shuma në Euro)	2005 Fondi i përgjithshëm Buxhet (Shuma në Euro)
<b>Arkëtimet</b>			
Granti Qeveritar		5,734,291	7,340,120
<b>Totali I arkëtimeve</b>	<b>3</b>	<b>5,734,291</b>	<b>7,340,120</b>
<b>Pagesat</b>			
Pagat mëditjet dhe përfitimet e punonjësve		2,256,431	2,329,561
Mallrat dhe shërbimet		1,553,313	1,726,906
Shpenzimet kapitale		1,924,547	1,250,000
<b>Totali shpenzimeve</b>	<b>4</b>	<b>5,734,291</b>	<b>5,306,467</b>
		-	-

Aprovuar në emër të Kuvendit të Kosovës

Kryetari i Kuvendit – Kolë Berisha



Data Aprovimit

25.08.2006

## **1. E KALUARA DHE AKTIVITETET**

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) është autorizuar të administrojë krahinën e Kosovës sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përfaqësuesi Special I Sekretarit Përgjithshëm (“PSSP”) në lidhje me autoritetin që I është dhënë atij nga Këshilli I Sigurimit të Kombeve të Bashkuara rezoluta nr. 1244, në 15 Maj 2001 ka shpallur “Kornizën Kushtetuese për Vetë-Qeverisje Lokale”( Rregullorja e UNMIK nr. 2001/9). Është shpallur me qëllim të organizimit dhe mbikëqyrjen e institucioneve të përkohshme për vetë-qeverisje demokratike dhe autonomi në Kosovë deri në statusin e ardhshëm përfundimtar të Kosovës.

Me 17 Nëntor 2001 zgjedhjet e para parlamentare janë mbajtur në bazë të dispozitave të rregullores së UNMIK 2001/9 për institucionet e përkohshme vetë qeverisëse, nga e cila është formuar Kuvendi i Kosovës.

Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë 2003/2 merret me procedurat e menaxhimit financiar në institucionet vetëqeverisëse. Udhëheqësi zyrtar financiar në Kuvendin e Kosovës është përgjegjës për regjistrimin e transaksioneve dhe mirëmbajtjen e regjistrimeve kontabël në përputhje me Rregullat Financiare dhe sipas nevojës ofrimin e kopjeve të regjistrimeve llogari-mbajtjes në Ministrin për Ekonomi dhe Financa. Shpenzimet mund të ndodhin nga fondet e alokuara dhe vetëm në pajtim me procesin i cili , në përputhje me Nenin 35.2, e themeluar nga Rregullat Financiare.

## **2. POLITIKAT E KONTABILITETIT**

### **2.1. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime të raportimit në Presidencën e Kuvendi të Kosovës në lidhje me aktivitetet e Kuvendit të Kosovës në pajtim me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombëtare të kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP), Raportimit financiar sipas Bazës së të hollave të kontabilitetit“.

Krahasimet nuk janë prezantuar pasi që Kuvendi i Kosovës ka raportuar vetëm formalisht si entitet i veçantë nga 1 Janari 2005. Në vitet e më hershme transaksionet e kuvendit janë përfshirë dhe raportuar si pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Krahasimet janë dhënë në Shtojcën 1 të pasqyrave financiare .

### **2.2. Pagesat nga entitet tjera qeveritare**

Shumat e caktuara Kuvendit të Kosovës janë menaxhuar nëpërmjet llogarisë qendrore të administruar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa ( MEF). Këto shuma janë shpërndarë në emër të Kuvendit të Kosovës nga Udhëheqësi I Thesarit në prezantimin e dokumentacionit dhe autorizimit adekuat. Shumave raportuar si Arkëtim/ (Pagesë) në Pasqyra të Arkëtimeve dhe Pagesave është shuma që MEF kanë alokuar/ paguar në dobi të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi I Kosovës nuk ka poseduar llogarinë e vetë bankare.

### **2.3. Valuta raportuese**

Valuta raportuese në Kuvendin e Kosovës është Euro.

### 3. ALOKIMET E AUTORIZUARA NGA MEF (GRANTET)

	<b>2005</b> <b>Alokuar</b>
<b>Grantet e alokuara gjatë vitit aktual:</b>	
Grantet për kompensimin e punonjësve	2,417,440
Grantet për mallra dhe shërbime	1,768,501
Grantet për investimet kapitale	2,631,666
<b>Alokimet e autorizuara nga MEF</b>	<u><b>6,817,607</b></u>
<b>Shumat e pashfrytëzuara</b>	<u><b>(1,083,316)</b></u>
<b>Shumat e paguara nga MFE në emër të KUVENDIT TË KOSOVËS</b>	<u><u><b>5,734,291</b></u></u>

### 4. PAGESAT OPERUESE

<b>Pagat, mëditjet dhe përfitimet e punonjësve</b>	<b>2005</b> <b>Pagesat e</b> <b>kontrolluara nga</b> <b>entitet Qeveritare</b> <b>(Shuma në Euro)</b>
Mëditjet neto	1,840,268
Taksat e mëditjes	202,435
Kontributi pensional nga punëtorët	106,864
Kontributi pensional nga punëdhënësi	106,864
<b>Totali</b>	<u><u><b>2,256,431</b></u></u>

**Mallrat dhe Shërbimet**

**2005**

**Pagesat e  
 kontrolluara nga  
 entitetet Qeveritare  
 (Shuma në Euro)**

Shërbimet teknike	312,615
Shpenzimet e udhëtimeve	240,353
Shërbimet kontraktuese	230,413
Karburanti	163,398
Furnizimet Zyrës	94,109
Shpenzimet e Postës Telefonike dhe komunikimit	91,710
Mëditjet	88,815
Shërbimet tjera	44,702
Shërbimet komunale	44,517
Mobiliet dhe pajisjet	22,292
Mirëmbajtja dhe riparimet	15,617
Shërbimet e përfaqësimit	11,352
Mallrat dhe shërbimet tjera (të përziera)	193,420
<b>Totali</b>	<b>1,553,313</b>

Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për aplikimin e procedurave të prokurimit. Auditoret kanë raportuar tek ne të testimi i auditimit kanë dëshmuar disa shembuj të mos përputhjes me rregulloret e prokurimit ( Ligjin mbi Prokurimin Publik 2003/17). Mos përputhja me rregulloret ngrit rrezikun e ndodhjes së parregullsive dhe të mbesin të pa zbuluara .

**Shpenzimet Kapitale**

**2005**

**Pagesat e  
 kontrolluara nga  
 entitetet Qeveritare  
 (Shuma në Euro)**

Ndërtesat (përfshirë koston e dizajnit dhe studimit)	1,688,047
Vetura blinduar (pagesa ne llogari)	236,500
<b>Totali</b>	<b>1,924,547</b>

Kostja e ndërtimeve me shumën prej 1,688,047 € lidhet plotësisht me Villa Germia. Kuvendi i informuar që procesi i aprovimit është i kërkuar nga Kuvendi, fillimi i një projekti kapital të tillë mund të mos jetë zbatuar në mënyrë adekuate dhe procedurat e prokurimit nuk janë plotësisht në pajtim me rregulloret. Pagesat në llogari me shumën prej 235,600 Euro është bërë për veturën e blinduar me 25 Nëntor 2005. Deri me datën e këtyre pasqyrave financiare vetura nuk është pranuar. Kuvendi nuk ka qenë në gjendje të marr ndonjë dëshmi dokumentuese përfundimtare e cila tregon vendndodhjen e veturës apo datën e pranuesë të dërgesës. Për me tutje Kuvendi është informuar që procedurat e prokurimit për blerjen e veturave nuk ka qenë në pajtim të plotë me rregulloret.



## Shtojca 1: Buxheti sipas informatave aktuale financiare

### KY INFORMACIONO ËSHTË OFRUAR PËR INFORMACION DHE NUK ËSHTË AUDITUAR

	Viti I përfunduar 31 Dhjetor 2005			Viti I përfunduar 31 Dhjetor 2004		
	Buxhetuar (në EURO)	Aktual (në EURO)	Diferenca (në EURO)	Buxhetuar (në EURO)	Aktual (në EURO)	Diferenca (në EURO)
<b>Arkëtimet</b>						
Granti Qeveritar	7,340,120	5,734,291	1,605,829	7,686,673	5,659,556	2,027,117
<b>Totali I arkëtimeve</b>	<b>7,340,120</b>	<b>5,734,291</b>	<b>1,605,829</b>	<b>7,686,673</b>	<b>5,659,556</b>	<b>2,027,117</b>
<b>Shpenzimet</b>						
Pagat dhe mëditjet	1,186,833	1,422,035	(235,202)		1,201,953	
Përfitimet e punonjësve	1,142,728	834,396	308,332		748,304	
<b>Totali Pagave, Mëditjeve dhe përfitimet e punonjësve</b>	<b>2,329,561</b>	<b>2,256,431</b>	<b>73,130</b>	<b>2,052,710</b>	<b>1,950,257</b>	<b>102,453</b>
Shërbimet teknike	258,181	312,615	(54,434)		212,131	
Shpenzimet e udhëtimit	442,531	240,353	202,178		35,040	
Shërbimet kontraktuese	19,804	230,413	(210,609)		442,678	
Karburanti	75,190	163,398	(88,208)		130,212	
Furnizimet për zyre	163,024	94,109	68,915		143,985	
Shpenzimi në post telefoni dhe komunikim	75,104	91,710	(16,606)		75,588	
Mëditjet	-	88,815	(88,815)		-	
Shërbimet tjera	21,483	44,702	(23,219)		344,735	
Shërbimet komunale /	110,896	44,517	66,379		45,186	
Mobiliet dhe pajisjet	150,825	22,292	128,533		28,823	
Mirëmbajtja dhe riparimet	64,449	15,617	48,832		13,209	
Shpenzimet e përfaqësimit	-	11,352	(11,352)		17,297	
Mallrat dhe Shërbimet tjera (të përziera)	345,419	193,420	151,999		209,522	
<b>Totali I Mallrave dhe Shërbimeve</b>	<b>1,726,906</b>	<b>1,553,313</b>	<b>173,593</b>	<b>1,806,843</b>	<b>1,698,406</b>	<b>108,437</b>
ndërtesa	1,250,000	1,688,047	(438,047)	1,900,000	432,471	
Veturat	-	236,500	(236,500)			
<b>Totali I Investimeve Kapitale</b>	<b>1,250,000</b>	<b>1,924,547</b>	<b>(674,547)</b>	<b>1,900,000</b>	<b>432,471</b>	<b>1,467,529</b>
<b>Totali I Pagesave</b>	<b>5,306,467</b>	<b>5,734,291</b>	<b>(427,824)</b>	<b>5,759,553</b>	<b>4,081,134</b>	<b>1,678,419</b>

**Shënim:** Nuk na janë ofruar informacione të detajizuara për shpenzimet buxhetore në Kuvend për vitin e përfunduar 31 Dhjetor 2004.